



RISHPALLJE E REKRUTIMIT

01Nr.111/01-3658/19

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, më datë 07.03.2019 rishpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

I. ZYRTAR PËR REGJISTRIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME DHE INFORMACION KADASTRAL

Drejtoria për urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit

Njësia/sektori – i kadastrit

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: niveli profesional , grada 9, koeficienti aktual- 7

Numri i referencës së vendit të punës: RN00004322

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësive dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;10%
2. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës; 15%
3. Bënë regjistrimin e kontratave të shitblerjeve, faljes, vendimeve të trashëgimisë, hipotekave, aktgjykimeve të gjykatave, si dhe vendime tjera të organeve tjera kompetente dhe i vendos në regjistrin e të drejtës së pronësisë së paluajtshme; 15%
4. Regjistron ngarkesat tatimore, përmirëson listat e njësive, regjistron kontratat e dhënies me qira të pasurisë së paluajtshme për 99 vite dhe vendos të dhënat në regjistrin e të drejtës së pronësisë së paluajtshme 15%
5. Bënë ndarjen e ngastrave, bashkimit e ngastrave, fshirjen e hipotekave dhe futjen e të dhënave në regjistrin e të drejtës së pronësisë së paluajtshme; 15%
6. Merr pjesë në marrjen e vendimeve lidhur me të drejtën e pronësisë së paluajtshme dhe i regjistron në regjistrin e të drejtës së pronësisë së paluajtshme; 15%
7. Regjistron të gjitha ndalesat që vijnë nga gjykata dhe organet tjera kompetente; 10;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrsi;5%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkojnë:

- Diplomë universitare- Fakulteti juridik , minimum 2 vite përvojë pune profesionale
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me pronësinë
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit : pa afat te caktuar

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik, prej 07.03.2019 deri më 21.03.2019.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar **-Zyra e pranimit**, kati përderesë dhe në web-faqen komunale . **Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente:**

Diplomën e Fakultetit të kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, ekstraktin e lindjes, vërtetimin-dëshminë e përvojës së punës, certifikata mbi trajnimet e kryera, dëshminë se nuk është në hetime.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”. “Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qëndrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e meritës do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.



Kryetari i Komunës
Besmir Ilazi